



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Dokument Parlamentar

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2019

RAPORT

PËR PROJEKTREZOLUTËN

**“PËR PROGRESIN SHQIPËRISË NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN
EVROPIAN PËRGJATË VITIT 2018”**

Komisioni Parlamentar për Integrimin European në mbledhjet e zhvilluara në datat 27.3.2019 dhe 1.04. 2019, respektivisht me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe me Ministrinë e Drejtësisë në përmbushje të detyrimeve të Shqipërisë për anëtarësimin e saj në Bashkimin European mori në shqyrtim raportimin e Këshillit të Ministrave për vitin 2018 “Mbi ecurinë e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin evropian”

Raportimi i Këshillit të Ministrave bëhet në respektim të Ligjit 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European, neni 18 dhe neni 19, si dhe Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, neni 103, pika 1 dhe 2.

Komisioni, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi çështjen në përputhje me rendin e dites dhe kalendarin e punimeve të tij.

Komisioni në datën 27.03.2019, organizoi një seancë dëgjimore me Z. Genti Cakaj, Ministër në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme. Në seancë dëgjimore u paraqit ecuria e reformave në kuadër të rekomandimeve të Komisionit European 2018 për Shqipërinë përsa i përket 5 përparësive kyçe, Administrata Publike, Reforma në drejtësi, Lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar dhe të drejtat e njëriut. Gjithashtu Ministri në detyrë informoi komisionin në lidhje me bisedimet që janë zhvilluar midis qeverisë shqiptare dhe Bashkimit European në të gjitha strukturat sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Komisioni u informua në lidhje me zbatimin e planit kombëtar për integrimin european 2018 – 2020.

Komisioni në datën 01.04.2019 organizoi një seancë dëgjimore me Znj. Etilda Gjonaj në lidhje me përparësitë që mbulon kjo ministri, specifikisht: Reforma në drejtësi, lufta kunder

korupsionit dhe të drejtat e njeriut. Fokus të veçantë iu kushtua çështjes së kthimit dhe kompensimit të pronave në Shqipëri.

Komisioni në datë 03.04.2019 shqyrtoi dhe miratoi projektrezoluten “Për progresin Shqipërisë në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian përgjatë vitit 2018.

Komisioni për Integrimin Evropian, vlerësoi punën e qeverisë dhe në ecurinë e reformave dhe rekomandoi që të vijohet më tej me qëllim arritjen e hapjes së negociatave.

Në veçanti komisioni rekomandoi që Kuvendi t’i kërkojë qeverisë:

1. të konsolidojë reformat e arritura dhe të vijojë të thellojë më tej reformat për plotësimin e pesë prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim.
2. të ruajë dhe forcojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të marrë pjesë në nismat rajonale, si dhe të zbatojë angazhimet në kuadër të Procesit të Berlinit.
3. të forcojë dhe përmirësojë më tej aktivitetin e organeve nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integrimit evropian, si Komisioni i Integrimit Evropian dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në procesin e integrimit evropian.
4. të vazhdojë të shqyrtojë me përparësi dhe në një proces të gjerë konsultimi, kuadrin ligjor që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe të gjitha nismat të cilat janë pjesë e agjendës reformuese të integrimit të Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën e vendit konventat ndërkombëtare dhe acquis-në e Bashkimit Evropian

Në përfundim, Komisioni me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, mbështetur në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, miratoi projekt-rezolutën bashkëlidhur këtij raporti, të cilën ia paraqet për miratim Kuvendit.

NËNKRYETARE

SENIDA MESI